

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak se, sipas mendimit të pakicës, ai arriti një nivel të besueshëm edhe në rivlerësimin e pasurisë, ndërsa në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe me pikat e tjera (me përjashtim të pikave nr 2.16 dhe 2.22 – nr. 4.29.(iii)–nr. 11.1.3) të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, të cilat nuk do të analizohen në vijim këtu, bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues, të shprehur në vendim.

Konkretisht, në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli do të duhej të ishte konfirmuar në detyrë, pasi ka arritur një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë së familjes së tij, duke u kristalizuar në përfundim të procesit të rivlerësimit vetëm një pamjaftueshmëri e mjeteve financiare, në nivel minimal, e cila, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe qëndrimeve të GJEDNJ-së e Kolegjit, nuk mund të passillte pasojën ekstreme të shkarkimit të këtij subjekti.

Konkluzioni i mësipërm bazohet, përpos fakteve dhe analizave arsyetuese të paraqitura në vendimin përkatës, edhe në vlerësimet ndryshe dhe në arsyetimin e pikave që vijojnë:

1. Lidhur me pikat 2.16 dhe 2.22 të vendimit, në lidhje me një shumë prej 1.6 milionë lekësh, të disponuar në gjendjen *cash* në vitin 2009, vërehet se ajo duhej të konsiderohej me burim të ligjshëm dhe të përlogaritej në analizën financiare, pasi rezultoi i provuar burimi i ligjshëm nga shitjet e pasurive të paluajtshme nga anëtarët e familjes *de facto*, konkretisht të prindërve të bashkëshortes së subjektit – të cilët edhe pse prej kohësh jetonin bashkë me vajzën e tyre dhe subjektin, nuk ishin subjekte deklarues e, kësaj, nuk kishin detyrimin të deklarimit gjendjen *cash* në banesë.

1.1 Nisur nga ky kontekst, vlerësohet se përpos pasaktësive në mënyrën dhe momentin e deklarimit të këtij burimi, funksioni primar i procesit të rivlerësimit të pasurisë është ai i evidentimit të burimeve të përdorura nga subjektet dhe familjarët e tyre, duke mbërritur në aplikimin e një mase (ekstreme) disiplinore, vetëm atëherë kur për vlera të konsiderueshme burimet nuk evidentohen apo rezultojnë jo të ligjshme. Në rastin konkret, burimi i shpjeguar nga subjekti është provuar si i ligjshëm, madje brenda familjes (“së madhe” *de facto*), por shumica i ka dhënë peshë përcaktuese mosdeklarimit në kohë reale të përdorimit të kësaj shume për një afat kohor të shkurtër.

1.2 Vlerësoj se në kontekstin e marrëdhënieve të posaçme familjare nuk mund të prevalojë pretendimi i formalitetit dhe deklarimit të përpiktë në kohë reale, pasi pikërisht veçantia e marrëdhënies dhe e dinamikës së lëvizjes së shumave në fjalë (prej 1,6 milionë lekësh, pra të krijimit, disponimit, përdorimit dhe kthimit brenda familjes), për sa kohë është konfirmuar dhe provuar burimi i ligjshëm, duket të kishte lënë më shumë vend për shumicën, që të aplikojë me *buon sens* konsiderimi i burimit të pretenduar, për sa kohë – ndonëse nuk është e provuar katërcipërisht – Komisioni as nuk mund ta përjashtojë mundësinë se faktet përkojnë me shpjegimet e subjektit dhe me deklaratimet e prindërve të bashkëshortes së tij, të cilët sikurse u përmend nuk duhet të kishin deklaruar as për krijimin e shumave të disponuara në gjendjen

cash dhe as për lëvizjet apo përdorimin e tyre, sikurse subjekti nuk kishte detyrim të deklaronte përdorimin e përkohshëm (dhe të kthyer brenda vitit) të një shume që disponohej brenda banesës së tij (nga prindërit e bashkëshortes).

1.3 Përjashtimi i të ardhurave familjare të dokumentuara, vetëm për faktin se midis familjarëve bashkëjetues nuk është provuar/dokumentuar qarkullimi i shumave monetare që kanë kontribuar në blerjen e një pasurie apo që ato nuk janë deklaruar specifikisht, nga Komisioni – pa u bazuar mbi ndonjë provë të kundërt konkrete dhe të qartë (e cila ndoshta mund të mundësonte përjashtimin nga rregulli gjithëpërfshirës i të ardhurave familjare të ligjshme) – do të konsistonte në cungimin dhe pakësimin artificial dhe të padrejtë të totalit të burimeve të një familjeje (qoftë edhe *de facto*), të përlllogaritura *ex post* – për sa kohë anëtar i familjes që ka disponuar këto shuma nuk ka pasur detyrimin ligjor që t'i deklaronte si gjendje *cash* dhe burimet financiare të përdorura (provizorisht) për krijimin e pasurisë *de qua* kanë rezultuar me burim të ligjshëm.

1.4 Në këto kushte mendoj se, përpos *buon sensit*, proporcionalitetit dhe çmimit harmonik të rrethanave faktiko-ligjore, do të duhej të ishte mbajtur në vëmendje edhe qëndrimi jurisprudencial i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili në disa vendime (që do të citohen në vijim) e ka qartësuar peshën jopenalizuese që kanë problematikat që lidhen me deklaratimet e subjekteve, por që nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të tyre – sikurse është rasti në analizë.

2. Lidhur me pikën 4.29.(iii) të vendimit, ku shumica arsyeton moskonsiderimin në analizë financiare të një shume prej 3.000 euro, të përfituar nga vëllai i subjektit. Sikurse në pikën e mësipërme, çmoj se një arsyetim i ngjashëm vlen edhe për sa i përket të ardhurave që subjekti ka marrë nga vëllai i tij me vendbanim në shtetin italian – sikurse është trajtuar në vendim, ku janë konsideruar të ardhura më larta të përfituara nga subjekti po nga ky vëlla. Për sa kohë gjendemi në një analogji të dyfishtë (si për sa përket ngjashmërisë me pikën e mësipërme në aspektin e marrëdhënies së veçantë dhe të pasaktësisë në deklarime nga njëra anë, por edhe të analogjisë faktike të arsytimit të kryer nga shumica për shumat e tjera të përfituara nga i njëjti vëlla) dhe në të njëjtin kontekst të marrëdhënies së veçantë (mes vëllezërve e familjarëve), çmoj se për sa kohë është provuar burimi i ligjshëm dhe disponibiliteti financiar i familjes së vëllait të subjektit, nuk bën sens që një pjesë të konsiderohet dhe një tjetër pjesë jo, kështu që vlerësoj të pabazuar përjashtimin nga analiza financiare të shumës 3.000 euro nga vëllai i subjektit, e cila duhet të shtohet.

2.1 Një tjetër arsye që më shtyn të vlerësoj se kjo shumë duhej të pranohej dhe konsiderohej si e ardhur me burim të ligjshëm nisët pikërisht nga shkaqet që shumica ka argumentuar në pikën vijuese të vendimit (4.29.iv – f. 37) lidhur me një tjetër shumë prej 8.000 euro me të njëjtin prejardhje, pra nga vëllai i subjektit. Në vlerësim të pakicës duket kontradiktor dhe i pabazuar moskonsiderimi i një shume prej 3.000 euro, duke pranuar pretendimin për një shumë prej 8.000 euro (pra pothuajse trefishin e së parës) të marra nga dikush (vëllai i subjektit), familja e të cilit ka rezultuar me mjaftueshmëri burimesh të ligjshme – sipas analizës së bërë nga Komisioni dhe të pasqyruar nga shumica në këtë vendim (faqet 38-40). Nga ana tjetër shpreh qëndrim ndryshe mbi peshën përcaktuese që i është dhënë mungesës së provës së kalimit të shumës prej 3.000 euro më Western Union, pasi dihet botërisht që afati i ruajtjes së të dhënave për këto shërbime transfertash është 5 vite, ndërkohë që bëhet fjalë për vitin 2001. Gjithashtu, nuk mund të ketë vlerë përjashtuese për një të ardhur për faktin se subjekti, ndonëse ka

deklaruar zërin e të ardhurave të përfituara nga vëllai, nuk ka qenë plotësisht i saktë në specifikimin sasior të vlerave të momenteve të ndryshme etj¹. Ndërkohë që, në vlerësimin tim, për sa kohë që burimi i ligjshëm i të vëllait është i provuar për të dyja shumat (8.000 + 3.000 euro), si dhe marrëdhënia është deklaruar nga subjekti dhe konfirmuar nga vëllai i tij – duke qenë edhe në një marrëdhënie të posaçme – do të duhej të ishte konsideruar edhe shuma prej 3.000 euro.

- 3. Lidhur me pikën 11.1.3 të vendimit** për automjetin tip “Mercedes-Benz”, të blerë në vitin 2005 dhe shitur në vitin 2009, vlerësoj se duhet të konsiderohet e disponueshme në vitin 2009 e gjithë shuma prej 600.000 lekë që ishte përfituar nga shitja e këtij mjeti, duke e ulur kështu pamundësinë me 200.000 lekë – ndërkohë që shumica ka konsideruar në analizë vetën 400.000 lekë. Ky konkluzion mbështetet në jurisprudencën e Kolegjit² edhe për shkak të diferencës jo të madhe që është konstatuar. Për më tepër, çmuj se vlera e kontratës prevalon ndaj prezumimit të pavërtetësisë mbi çmimin e deklaruar, për sa kohë bëhet fjalë për marrëdhënie të lirë tregtare, ku çmimi dakordësohet mes palëve me vullnet të lirë, vlera e pasqyruar në kontratën e shitblerjes prevalon mbi dyshimet e mundshme dhe vetëm përballë një difference më të theksuar dhe elementeve të tjera rrethanore mbi ndonjë trajtim preferencial, favorizim apo konflikt interesash mund të konsiderohej i pranueshëm qëndrimi i shumicës.
- 4.** Në përmbledhje të sa është shprehur në pikat e mësipërme, vërehet se duke i konsideruar si të ardhura të ligjshme vlerat: (i) 1,6 milionë lekë; (ii) 3.000 euro (të konvertueshme asokohe në rreth 400.000 lekë); (iii) 200.000 lekë, të cilat në total shkojnë në rreth 2.200.000 lekë të munguara në bilancin e analizës së përgjithshme financiare, që sipas shumicës ka rezultuar me një pamundësi prej 2.821,616 lekësh. Kështu, duke u konsideruar sa më sipër pamundësia financiare, në këtë rast do të ishte pothuajse e papërfillshme (në raport me periudhën kohore 18-vjeçare për të cilën është kryer analiza financiare gjithëpërfshirëse) në një vlerë prej rreth - 600.000 lekësh. Gjithashtu, edhe duke u ndalur me analizimin e burimeve në datat specifike të krijimit apo përdorimit të pasurive të paluajtshme e të luajtshme (përpos vlerësimit vjetor) sërish do të gjendeshim në një pamundësi financiare prej rreth 1,3 milionë lekësh, duke mbetur në një nivel më se të kapërcyeshëm, pra që nuk e pengonte konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, bazuar kjo në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit dhe në qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në raste të ngjashme.
- 5.** Në këto kushte, sipas pakicës, duke i konsideruar të gjitha burimet e ligjshme të gjeneruara, të disponuara nga çdo anëtar i familjes (*de facto*), si dhe duke marrë në konsideratë edhe shumat e trajtuara në pikat e mësipërme (konkretisht 1.6 milionë të marra përkohësisht nga prindërit e bashkëshortes së subjektit dhe 3.000 euro nga vëllai i tij, si dhe nga shitja e automjetit vlerën prej 200.000 lekë), bazuar në arsyetimet e mësipërme, përfundimisht nga përlllogaritjet e analizës financiare mbi të ardhurat monetare, për të cilat burimi është provuar me dokumentacion ligjor, duke zbritur shpenzimet përkatëse, për vitet në fjalë, siç janë detajuar në tabelën që vijon, ka rezultuar një pamundësi totale në rastin më negativ, rreth 1.2 milionë lekë.

¹ Gjithashtu edhe Kolegji ka qartësuar në vendimin nr. 37/2021 etj., se pasaktësitë në deklarime nuk shoqërohen me pamundësi financiare dhe nuk mund të sjellin pasoja për subjektin.

² Shihni vendimet nr. 25/2023 dhe nr. 40/2022 etj.

6. Për rrjedhojë, në mungesë të një pamundësie të konsiderueshme financiare subjekti nuk mund të penalizohet thjesht për shkak të mosdeklarimit të saktë të disa shumave të disponuara nga familjarë, të cilët kanë konfirmuar marrëdhënien dhe kanë provuar burimin e ligjshëm të mjeteve monetare të përdorura nga subjekti, për sa kohë bëhet fjalë për pasaktësi të tolerueshme dhe jo të mjaftueshme për aplikimin e masës disiplinore.
7. Gjithashtu ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentet ligjore të paraqitura në Komision burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e pasurive të tij dhe nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm.
8. Nga sa më lart, pakica arrin në përfundimin se pasaktësitë e deklarimeve të përshkruara (dhe të argumentuara edhe nga shumica në këtë vendim) nuk janë me një peshë specifike të tillë që të krijojnë bindjen se ato në vetvete apo edhe së bashku me pamundësinë financiare të rezultuar (si në tabelën më lart) mund të përbëjnë shkak për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, të parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi kjo masë, në vlerësimin tim, do të rezultonte tejte e ashpër, jo në raport të drejtë me faktet e provuara dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit.

8.1 Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në metodologjinë e rivlerësimit për këtë kriter, të përshkruar më sipër, unë, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli, nuk është i drejtë, pasi çmoj se i ka përmbushur të tria kushtet e parashikuara në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Për arsyet e sipërcituara sipas parashikimeve të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni, në përgjigjet e subjektit dhe në deklaramet e bëra prej tij në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli ka arritur një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për rrjedhojë, krijohet bindja se shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por konfirmimin e tij në detyrë.

**Anëtar në pakicë/kundër
Lulzim HAMITAJ**